

Zyra gjermane mirënjohje për më të mirët e kolegjit “Loyla” në Prizren

Kur Kosova të bëhet e pavarur, Zyra gjermane do të shndërrohet në ambasadë, u është thënë nxënësve prizrenas

PRISHTINË, 14 QERSHOR – Zyra gjermane në Prishtinë i ka shpërblyer dymbëdhjetë nxënës të kolegjit “Loyla” të Prizrenit, të cilët kanë treguar sukses më të lartë në një garë të gjuhës gjermane, të zhvilluar në këtë kolegji. Nxënësit janë pritur të enjten në Zyrën gjermane në Prishtinë, të cilëve u janë ndarë mirënjohje dhe dhurata nga shefi i kësaj zyre, Eugen Wolfarth. Nxënësit e këtij kolegji nuk u janë gëzuar edhe aq dhuratave të cilat i pranuan, sa i janë gëzuar një tregimi që dëgjuan në Zyrën gjermane, nga atasheu i kulturës.

Duke i njoftuar nxënësit me funksionimin e zyrës, atasheu Erish Rabiç ka thënë se kur Kosova të bëhet e pavarur, poshtë zyrës do të shkruhet Ambasada gjermane.

Për Eugen Wolfarth, shefi i Zyrës gjermane, është shumë me rëndësi që njerëzit të mësojnë gjuhë të huaja, gjë që ju ndihmon të komunikojnë me popuj të ndryshëm, por edhe të ngritin horizontet e dijes. Wolfarth ka

theksuar se një garë leximi është shumë e mirë sepse u jep nxënësve një nxitje për të mësuar më tepër, e për këtë arsye, ai theksoi se zyra të cilën udhëheq do të organizojë gara të tilla.

“Duke mësuar gjuhën, natyrisht se e mëson edhe kulturën e atij vendi, e në rastin e Kosovës dhe Gjermanisë është shumë e mirë kjo, sepse ka shumë njerëz të Kosovës të cilët jetojnë në Gjermani. Kjo në kuptim të plotë të fjalës është në shërbim të popujve”, është shprehur Wolfarth. Gara për të përzgjedhur nxënësit më të mirë në gjuhën gjermane është organizuar nga vetë kolegji në bashkëpunim me Zyrën gjermane, dhe ka pasur për qëllim që të stimulojë nxënësit në drejtim të mësimi të gjuhës.

Gjimnazi “Loyla” është hapur në vitin 2005 në Prizren. Në të ndjekin mësimin 315 nxënës në shkollën e mesme të ulët, prej klasës së gjashtë e deri në të dymbëdhjetën.

B. Krasniqi